

**STATUTI DHE AKTI THEMELIMIT**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"RETREAT Group" SHPK**

**Kreu I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**FORMIMI I SHOQËRISË**

**Neni 1**

a. Sot në Tiranë në datën 06 Prill 2024 themelohet shoqëria tregtare me përgjegësi të kufizuar emërtuar "**RETREAT Group**" shpk, me vullnet shoqëritë tregtare. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "**RETREAT Group**" shpk, formohet nga ortaku themelues:

**LAURA FERATI** shtetas shqiptare, i datëlindjes 10.10.1988 lindur Vlorë, banues ne Shqiperi, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore, me nr ID I86010104B.

b. I cili me vullnetin e tij të lirë dhe në përputhje me Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe Aktin e Themelimit, kanë vendosur të destinojnë në këtë sipërmarrje kapitalin e tyre, me qëllim që të përfitojnë të ardhurat që mund të vijnë nga veprimtaria private e Shoqërisë, si dhe të përballojë humbjet deri në kufirin e vlerës së kontributit në Kapitalin Themeltar.

c. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në bazë të ekonomisë së tregut të lirë. Shoqëria tregtare "**RETREAT Group**" SHPK., fiton Personalitet Juridik nga dita e rregjistrimit të saj pranë zyrës së Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit në Tiranë.

**FORMA DHE EMËRTIMI I SHOQËRISË**

**Neni 2**

- Shoqëria tregtare, është e organizuar si Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar.
- Emërtimi i Shoqërisë është: "**RETREAT Group**" SHPK.
- Në rast transferimi të veprimtarisë tregtare, mund të ruhet i njëjtë emërtim, me kusht që Personi Juridik të shfojë në këtë emërtim një shënim i cili ka të bëjë me transferimin.

**SELIA E SHOQËRISË**

**NENI 3**

- Shoqëria tregtare "**RETREAT Group**" SHPK., ka selinë qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë në qytetin **Vlorë, Rruga Gjergj Arianiti ,Pallati Jumbo, Hyrja 1 ,Kati 12, Ap.2.**
- Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqesimi apo agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.
- Ajo mund të jetë pjesëmarrëse në një shoqëri tregtare apo mund të kontrollojë shoqëri të tjera tregtare si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- Njësitë strukturore të shoqërisë në format e mësipërme do të krijohen në perputhje me legjislacionin shqiptare kur ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, dhe jashtë saj në përputhje me legjilacionin e vendit ku Personi Juridik ka qendrën e tij.
- Shoqëria do të ketë vulën e saj.

**KOHËZGJATJA**

**Neni 4**

- Shoqëria Tregtare "**RETREAT Group**" SHPK., do të përbushë objektin e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.
- Ndryshimet e shoqërisë duke përfshire edhe përcaktime të mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasojë krijimin e një Personaliteti të ri Juridik.

**OBJEKTI I VEPRIMTARISË**



## Neni 5

Objekti i shoqerise "RETREAT Group " SHPK do të jetë:

Ajensi udhëtimi, biletë udhëtimi, turizëm shëndetësor, konsulencë turizmi, organizim eventesh turistike, konsulencë marketingu, konsulencë per burimet njerëzore, konsulencë ne prona dhe vlerësimi prone, makina me qera, siguracione, hoteleri, agjensi turistike, promovim turizmi vendas dhe jashtë vendit, agroturizem, import dhe eksport, spa, restorante, bashkepunim me pale te treta ne sherbimet turistike.

## .TË DREJTATE SHOQËRISË

### Neni 6

Shoqëria tregtare "RETREAT Group" SHPK., nuk përgjigjet për detyrimet që rrjedhin nga veprimitaria ekonomiko-tregtare apo industriale që ortakët zhvillojnë në mënyrë të pavarur prej saj.

Shoqëria mund të ndryshojë emrin, selinë, kohëzgjatjen, objektin e veprimitarisë, administratorin, sipas vendimeve që do të marrin ortakët.

## KAPITALI I SHOQËRISË

### Neni 7

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1,000,000 lekë (Një milion lekë), i cili është têrësisht kapital financiar. Kapitali themeltar është ne një kuotë: 1 (një) kuotë me vlerë nominale 1,000,000 lekë ( Një milion lekë) dhe një kuotë me vlerë nominale 1,000,000 lekë (Një milion lekë). Kapitali themeltar zotërohet nga:

**I.LAURA FERATI** zotërues i 1 (një) kuote apo 100% të kapitalit të shoqërisë.

Ortaku ka të drejtë të tjetersoje, të zmadhoje apo të pakësojë kuotat e kapitalit deri në kufinjtë e përcaktuara nga ligji. Kapitali fillestare nuk është paguar.

### NENI 8

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera të veçanta të financimit për zhvillimin ekonomik e tregtar.

### NENI 9

1. Përbërja e kapitalit të shoqërisë, fondet e krijimit të saj si dhe përdorimi e rregullimi i çdo fondi të veçantë përcaktohen nga Ortakët sipas të drejtave dhe detyrave të përcaktuara në statut.
2. Të ardhurat e përgjithëshme të shoqërisë dhe në përgjithësi çdo operacion financiar i saj do të pasqyrohet në kontabilitetin e shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi dhe në mbështetje të akteve përkatëse të rrjedhura prej tij.

### NENI 10

1. Shoqëria Tregetare "RETREAT Group" SHPK., është pronare e pasurisë së saj të cilën e përdor dhe e disponon në emer të saj në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimitarisë së shoqërisë.
2. Shoqëria është e lirë të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera materiale në perputhje me legjislacionin përkatës shqiptare.
3. Të gjitha shpenzimet për ushtrimin e aktivitetit tregtar, asistencë teknike e juridike paguhën nga fondet e shoqërisë.

### NENI 11

1. Pasuritë e shoqërisë vlerësohen në monedhë shqiptare.
2. Aktiviteti financiar i shoqërisë do të mbylljet me 31 Dhjetor të çdo viti dhe bilanci do të miratohet brenda tre muajve të vitit në vazhdim.
3. Llogaritë vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e veçanta të hartuara nga Ortakët dhe nëse e kërkon ligji nga eksperti kontabël i autorizuar miratohen me Vendim të Ortakëve të saj.

### NENI 12

Pjesët e kapitalit themeltar nuk janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie. Ato nuk janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarje pasurore midis bashkëshortëve si dhe ndërmjet pasardhësve dhe paraardhësve.

### NENI 13

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar me trashëgimi ose brenda familjes personave përfitues do të bëhet pasi ata të pranojnë përbajtjen e statutit të kësaj shoqërie tregtare me gjithë ndryshimet që ai mund të ketë pësuar deri në momentin që këto pjesë të kapitalit themeltar bëhen të transferueshme.

#### **NENI 14**

Në rast mospranimi, pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri vetëm me miratimin e Ortakëve.

#### **NENI 15**

Zmadhimi i kapitalit themeltar me anën e kontributeve në para dhe në natyrë apo i zvogëlimi i tij bëhet me Vendimin e Ortakëve të shoqerise mbi bazën e një projekti të paraqitur nga ekonomisti i firmës ose kontabli i miratuar.

### **KREU I DYTË**

#### **ORTAKËRIA**

##### **NENI 16**

Ortakët e shoqërisë tregtare "RETREAT Group" SHPK., gjëzojnë të gjitha të drejtat dhe marrin përsipër detyrimet që pasqyrohen në legjislacionin e Republikës së Shqiperise, në Aktin e Themelimit dhe në Statutin e Shoqërisë.

#### **Të drejtat dhe detyrat e Ortakëve**

##### **NENI 17**

1. Të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve duke ushtruar të drejtën e votës së tij;
2. Të paraqesë pyetje me shkrim në lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqërisë ndaj administratorit;
3. Të informohet mbi përbajtjen e raportit të administrimit, inventaret e llogaritë vjetore, tekstet e vendimeve të propozuara, dhe raportin e ekspertit kontabël;
4. Të përfitojë nga fitimi i shoqërisë;
5. Të kërkojë prishjen e shoqërisë në rrethana të caktuara;

### **KREU I TRETË**

#### **DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

##### **NENI 18**

1. Sipas nevojave që paraqiten për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë, asambleja e ortakëve emëron dhe punëson administrator dhe drejtues teknik, të cilët qëndrojnë në detyrë deri sa revokohen nga shoqëria ose largohen me dëshirën e tyre. Administratori i emëruar i ka të gjitha kompetencat për të vepruar në emër të shoqërisë me përjashtim të rasteve të veçanta që ligji i jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.
2. Shoqëria do të administrohet nga administratori **LAURA FERATI** i cili përfaqëson shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët për një periudhë 5 (pesë) vjecare dhe me të drejtë rizgjedhje.
3. Administratori mund t'i delegojë kompetencat e tij me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.
4. Shoqëria në të ardhmen mund të administrohet dhe nga një administrator tjeter, i cili emërohet me Vendim të Ortakëve.

#### **ASAMBLEJA**

##### **NENI 19**

1. Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë.
2. Ortakët mund t'i delegojnë kompetencat e tyre me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.
3. Çdo klauzolë e kundërt është e pavlefshme në këtë rast.

##### **NENI 20**

Asambleja e Ortakëve ka të drejtë :

1. Të hartojë e miratojë ndryshimet në Statut;
2. Të miratojë bilancin vjetor të shoqërisë
3. Të vendosë për zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
4. Të emërojë dhe shkarkojë administratorin e shoqërisë;
5. Të shpallë prishjen, likuidimin dhe falimentiimin e shoqërisë;
6. Të shprehet për kohëzgjatjen e shoqërisë;
7. Të miratojë marrëveshjet e arritura në qarkullimin civil të saj;
8. Të miratojë strukturat e shoqërisë etj.;
9. Çdo vendim tjetër që i njihet nga ligji, Akti i Themelimit të shoqërisë dhe Statutit të saj.
10. Proces verbalet e mbledhjeve ruhen në selinë e shoqërisë.



## TË DREJTAT E ADMINISTRATORIT

### NENI 21

Administratori ka këto të drejta:

1. Të përfaqësojë shoqerinë në marrëdhënet e saj me të tretët, e në administratën publike;
2. Të emërojë pranë shoqërisë personelin e domosdoshëm që i nevojitet asaj në përbushjen e aktivitetit tregtar dhe ekonomik;
3. Të paraqesë për miratim në Asamblenë e Ortakëve strukturën e brendshme organizative të shoqërisë me emra përkates dhe të përbushë të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni i punës i Republikës së Shqipërisë;
4. Të administrojë pasurinë dhe mjetet financiare të shoqërisë brenda kufijve të caktuar nga Asambleja e Ortakëve;
5. Të testojë aftësitë e punonjësve në administratë;
6. Të thërrasë Asamblene e Ortakëve dhe të propozojë çështjet që duhen analizuar;
7. Të hartojë objektivat e shoqërisë për çdo vit pasues dhe të vendosë e të ndjekë realizimin e detyrave të lëna nga Vendimet e marra nga Ortakët;
8. Të hartojë planet e llogarive ekonomike dhe t'i paraqesë ato për miratim nga Asambleja e Ortakëve.

### NENI 22

Administratori është përgjegjës individualisht sipas rastit ndaj vetë shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

### NENI 23

1. Shoqëria organizon kontrollin e brendshëm me ekonomist të licencuar dhe kur kërkohet nga ligji me një ekspert kontabël të autorizuar, të cilët janë përgjegjës për problemet që mund të shkaktojnë nga moskryerja në rregull e detyrës së tyre.
2. Për emërimin, kompetencat, detyrimet, përgjegjësitë, zëvendësueshmërinë, tërheqjen, shkarkimin dhe shpërblimin e tij zbatohet legjislacioni shqiptare në fuqi.

### NENI 24

1. Të gjithë personat që do të punësohen pranë kësaj shoqërie, punësimi i tyre do të bëhet mbi bazën e kontratës individuale apo kolektive, sipas rastit, në të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet ligjore të secilës palë si dhe paga mujore në perputhje me legjislacionin shqiptare në këtë fushë.
2. Marrja në punë bëhet me rregjistrimin nga punëdhënesi në Librin e Punës së Shoqërisë, si dhe duke njofuar organet e Punës së Juridiksionit ku ushtron aktivitetin Shoqëria.
3. Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punës, bëhet në bazë të një akti me shkrim të lëshuar nga Administratori. Largimi lidhet me mbarimin e kontratës së punës për shkak të shkeljeve disiplinore ose me kërkësen e të interesuarit. Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së Shoqërisë, do të zgjidhen me mirëkuptim të palëve, të cilat për këtë qëllim mund të caktojnë nga një përfaqësues me prokurë. Kur mirëkuptimi nuk është i mundur, palët i drejtohen Gjykatës të Rrethit Gjyqësor.

### FORCAT MADHORE

#### NENI 25

Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi kur ka paaftësi paguese pjesore apo të plotë për kryerjen e detyrimeve të tij kur kjo është si pasojë e rrethanave të forcave madhore që vërtetohen pas nënshkrimit të kontratës dhe ortakët nuk mund ti shmanget me masa të arsyeshme.

Ngjarje të forcave madhore janë ato që i shpëtojnë kontrollit të ortakëve.

Kur ortakët ndodhen në paaftesi të plotësujnë detyrimet e tij për arsyen të forcave madhore, në bazë të kontratës dhe statutit duhet të bëjnë cdo përpjekje që ta kapërcejnë këtë vështirësi.

### SHPËRNDARJA E SHOQËRISË

#### NENI 26

Shpërndarja e shoqërisë mund të vijë në edo kohë dhe për çfarëdo shkaku.

Shoqëria mund të prishet para kohe;

-Me vendim të ortakëve,

-Kur mbaron kohëzgjatja e shoqërisë.

-Pas dy vjetëve të veprimtarisë me bilanc negativ (Humbje).

-Me vendim të gjykatës ose për arsyen të tjera të parashikuara në statut.

Në rast mbyllje ortakët vendosin mbi mënyrat e likuidimit dhe caktojnë një ose më shume likuidatorë duke ju përcaktuar dhe detyrat. Në rastin e likuidimit emërtimi i shoqërisë do të shoqërohet nga shënim "Shoqëri në likudim".

Mbasi bëhet njofimi i mbylljes së likuidimit dhe kryen formalitetet e duhura, shoqëria çregjistrohet nga regjstri tregtar i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

## **BAZA LIGJORE**

### **Neni 27**

E gjithë veprimtaria e shoqërisë do të bazohet në ligjin 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe në përgjithësi në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

## **RUAJTJA E SEKRETIT**

### **Neni 28**

Ortakët detyrohen që të mos nxjerrin tek të tretët të dhëna dhe njoftime sekrete që kanë të bëjnë me veprimitaritë ekonomike të shoqërisë.

Ortakët e shoqërisë përcaktojnë llojin e të dhënavëve dhe informatave që konsiderohen sekrete.

## **DISPOZITA TË FUNDIT**

### **NENI 29**

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohet Ligji "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe Legjislacioni shqiptare në fuqi.

### **NENI 30**

Ky Statut hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqerisë në Rregjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit në Tiranë.

### **NENI 31**

Ky Statut përpilohet në 3 (tre) kopje origjinale secili me të njëjtën vlerë ligjore. Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

**ORTAKU:**

**LAURA FERATI**